



**Prishtinë: 21/06/2007**  
**Kodi i ZRRE-së: D\_055\_2007**

***Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke marr parasysh:***

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë; dhe
2. Kërkesën e KEK SH.A të datës 14 Qershor 2007, në seancën e mbajtur më 21 Qershor 2007 ka nxjerrë këtë:

**VENDIM**

1. **Mbështetet** përgjigja e ZRRE-së e dhënë në Njoftimin e datës 15 Qershor 2007 sa u përket kërkesave në Paragrafët një (1) dhe dy (2) të Kërkesës së KEK SH.A të datës 14 Qershor 2007.
2. **Refuzohet** kërkesa nën Paragrafin tre (3) për derogimin e Neneve 3.2 (g), 20, 22.5 dhe 24.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, pasi që ZRRE-ja vlerëson se ky Rregull është në pajtueshmëri me Ligjin për Energji Elektrike.
3. ZRRE-ja së bashku me konsulentët e saj, së shpejti do të fillojë një vlerësim të gjithmbarshëm të pajtueshmërisë së legjislacionit primar dhe sekondar që është në fuqi në Kosovë, veçanërisht dispozitat e Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë që i përkasin licencimit të tregtarëve të jashtëm të energjisë elektrike në Kosovë.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura, mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së. Ankesa nuk do ta ndalojë ekzekutimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit ose në datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Naim Bejtullahu, anëtar

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar